

2019-2020

MICS në Republikën e Kosovës

dhe

MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës

## Disiplinimi i fëmijëve



Anketa e Treguesve të Shumëfishtë




### Disiplinimi i fëmijëve


#### Format e Disiplinimit të Fëmijëve

##### Kosovë


Vetëm disiplinim jo të dhunshëm




Ndëshkim fizik



Dhunë psikologjike



Çfarëdo disiplinimi i dhunshëm: SDG 16.2.1



Përqindja e fëmijëve të moshës nga 1 deri në 14 vjeç që kanë përjetuar ndonjë metodë të disiplinimit në muajin e kaluar, sipas llojit

**Ndëshkimi fizik:** Shtrëngimi, goditja ose qëlluarja me shuplakë e një fëmije në dorë/krah/këmbë, goditja në të pasme ose diku tjetër në trup me një send të fortë, goditja ose qëlluarja me shuplakë në të pasme me dorë, goditja ose qëlluarja me shuplakë në fytyrë, kokë ose veshë, dhe goditja ose rrahja e rëndë dhe e vazhdueshme.


**Ndëshkimi i rëndë fizik:** Goditja ose qëlluarja me shuplakë në fytyrë, kokë ose veshë dhe goditja ose rrahja e rëndë dhe e vazhdueshme e një fëmije.

**Dhuna psikologjike:** Bërtitja, ulëritja ose thirrja me zë të lartë ndaj një fëmije, si dhe thirrja e një fëmije me emra fyes si 'budalla' ose 'dembel'.


**Disiplinimi i dhunshëm :** Çdo ndëshkim fizik dhe/ose dhunë psikologjike.

#### Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë


Vetëm disiplinim jo të dhunshëm




Ndëshkim fizik



Dhunë psikologjike




Çfarëdo disiplinimi i dhunshëm: SDG 16.2.1




Përqindja e fëmijëve të moshës nga 1 deri në 14 vjeç që kanë përjetuar ndonjë metodë të disiplinimit në muajin e kaluar, sipas llojit

## Disiplinimi i dhunshëm: Pabarazitë



Për qindja e fëmijëve të moshës nga 1 deri në 14 vjeç që kanë përjetuar ndonjë metodë të disiplinimit të dhunshëm në muajin e kaluar, sipas karakteristikave të përgjithshme




Për qindja e fëmijëve të moshës nga 1 deri në 14 vjeç që kanë përjetuar ndonjë metodë të disiplinimit të dhunshëm në muajin e kaluar, sipas karakteristikave të përgjithshme

(R) Indeksi i pasurisë është ndërtuar duke përdorur informacionin mbi asetet e ekonomive familjare me supozimin se kjo reflekton pasurinë afatgjatë, duke i renditur ekonomitë familjare sipas pasurisë, nga më të varfërat te ato më të pasurat. Llogaritjet janë kryer veçmas në mostrën për MICS për Kosovë dhe mostrën për MICS me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, duke përdorur karakteristikat për secilën mostër përkatëse. Rezultatet e llogaritura të pasurisë pra janë të zbatueshme vetëm për të dhënat e veçanta në të cilat bazohen dhe ndryshojnë për dy anketat. Gjetjet sipas rezultateve të pasurisë të llogaritura për MICS me Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian tregohen me '(R)' në grafikon.


## Mesazhet kryesore

- Përderisa 24 për qind e fëmijëve të moshës 1-14 vjeç në Kosovë kanë përjetuar vetëm metoda të disiplinimit jo të dhunshëm, një pjesë e madhe e fëmijëve (72 për qind) kanë përjetuar çfarëdo lloji të disiplinimit të dhunshëm.
- Për qindja e fëmijëve të kësaj moshe që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian që kanë përjetuar ndonjë disiplinim të dhunshëm është 80 për qind (16 për qind përjetojnë vetëm metoda të disiplinimit jo të dhunshëm)
- Midis 30 për qind të fëmijëve të moshës 1-14 vjeç që kanë përjetuar ndëshkim fizik, 6 për qind kanë përjetuar ndëshkim të rëndë fizik (46 për qind dhe 13 për qind, përkatësisht, për fëmijët që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian).
- Në popullatën e përgjithshme, prevalenca e çfarëdo forme të disiplinimit të dhunshëm lidhet negativisht me arsimimin e nënës.
- Në mesin e fëmijëve të moshës 2-14 vjeç në Kosovë, fëmijët me vështirësi funksionale kanë më shumë të ngjarë të përjetojnë ndonjë disiplinim të dhunshëm (82 për qind), sesa fëmijët pa ndonjë vështirësi funksionale (72 për qind). Modeli është i kundërt midis fëmijëve të kësaj moshe që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
- 1 në 7 nëna/kujdestarë të fëmijëve të moshës 1-14 vjeç në popullatën e përgjithshme raportuan se ndëshkimi fizik është i domosdoshëm për të rritur ose edukuar fëmijën. I njëjti qëndrim u shpreh nga 1 në 3 nëna/kujdestarë që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
- Si në popullatën e përgjithshme ashtu edhe në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, nënat/kujdestarët e fëmijëve të moshës 1-14 vjeç me nivele më të ulëta arsimimi dhe ato që jetojnë në familje nga kuintilët më të varfëra të indeksit të pasurisë kanë më shumë të ngjarë të raportojnë se ndëshkimi fizik është i domosdoshëm për të rritur ose edukuar fëmijën.

## Disiplinimi i dhunshëm: Modelet e moshës Kosovë




## Ndëshkimi fizik: Qëndrimet dhe përvojat Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës nga 1 deri në 14 vjeç që kanë përjetuar ndonjë disiplinim të dhunshëm në muajin e kaluar, sipas llojit dhe sipas moshës

## Disiplinimi i dhunshëm: Modelet e moshës Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




## Ndëshkimi fizik: Qëndrimet dhe përvojat Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës nga 1 deri në 14 vjeç që kanë përjetuar ndonjë disiplinim të dhunshëm në muajin e kaluar, sipas llojit dhe sipas moshës


## Qëndrimet ndaj ndëshkimit fizik

### Kosovë



Përqindja e nënave/kujdestareve që mendojnë se ndëshkimi fizik është i domosdoshëm për të rritur ose edukuar fëmijët, sipas karakteristikave të tyre të përgjithshme  
 (\*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara

### Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e nënave/kujdestareve që mendojnë se ndëshkimi fizik është i domosdoshëm për të rritur ose edukuar fëmijët, sipas karakteristikave të tyre të përgjithshme  
 ( ) Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara  
 (\*) Shifrat që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë realizuar në 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS. Mbështetja teknike u sigurua nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), me fonde të siguruar nga Ministria e Financave (MF), Qeveria e Luksemburgut, Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë (MFK), UNICEF, Ekipi i Kombeve të Bashkuara të Kosovës (UNKT), Fondi i Popullsisë i Kombeve të

Bashkuara (UNFPA) dhe UN Women. Qëllimi i kësaj pasqyre të shkurtër informative është shpërndarja e gjetjeve të zgjedhura nga MICS 2019-2020 në Kosovë dhe MICS 2019-2020 me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë lidhur me disiplinimin e fëmijëve. Të dhënat nga kjo pasqyrë mund të gjenden në tabelat PR.2.1 dhe PR.2.2 në Raportin e Gjetjeve të Anketës (treguar me shkronjën 'R' për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë).

Pasqyrat tjera të shkurtra informative statistikore dhe Raporti i Gjetjeve të Anketës për këtë anketë dhe anketa të tjera janë në dispozicion në [mics.unicef.org/surveys](https://mics.unicef.org/surveys).